QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

Gazetë Tremujore

Edicioni Nr. 8 Mars 2021

Kjo gazetë, është një publikim tremujor që pasqyron aktivitetet e Qendrës Kombëtare Burimore dhe zhvillimet më të fundit në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri, mundësitë për financim, rritje kapacitetesh e rrjetëzim për OShC-të si dhe informacione të tjera relevante nga rajoni e më gjerë.

NË KËTË EDICION

AKTIVITETET E QKB-SË

Organizatat e Shoqërisë Civile i rekomandojnë Kuvendit të dërgojë për Opinion Ligjor në Komisionin e Venecias projektligjin "Për Regjistrimin e OJF-ve" dhe të shmangë miratimin e tij në kushtet e urgjencës

Ligji "Për regjistrin qendror të llogarive bankare "

Event Rrjetëzimi - Qendrueshmëria e organizatave rinore në periudhën e pandemisë dhe pas pandemisë

Forcimi i rrjeteve dhe koalicioneve të OSHC-ve në Shqipëri për më shumë nisma dhe impakt më të madh

Takim konsultues me OSHC-të mbi "Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit"

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri

Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Akademia e OJF-ve

Programe Trajnimi për OSHC-të

Sesione Informimi dhe Asistence mbi procedurën e regjistrimit të OJF-ve sipas ligjit "Për regjistrin e pronarëve përfitues"

ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTOR

Forumi Kombëtar 'Qeverisje për Ndryshim: Propozime të Shoqërisë Civile'

Kuadri ligjor dhe rregullator mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit për sektorin jo-fitimprurës në Shqipëri

Negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe eksperienca rajonale – Kapitulli 23 në fokus

Workshop Kombëtar "Nisma qytetare në veprimtarinë vendimmarrëse të Parlamentit"

VullnetarizmiPikëAL

Konferencë Kombëtare "1 Vit Ligji i Rinisë"

Raport për pjesëmarrjen e publikut dhe shoqërisë civile në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2020

Kuvendi Miraton Ndryshime të Rëndësishme të Reformës në Drejtësi në Mungesë të një Procesi Konsultimi dhe Transparence - Deklaratë për media

Raporti - Country Gender Equality Brief Albania 2020 – UN Women

TACSO 3 - Takime konsultuese për Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2021-2027

Hartëzimi dhe Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të Rrjeteve të OSHC-ve në Rajon dhe Projekteve Rajonale të financuara nga CSF

Konferencë Rajonale mbi Praktikat më të Mira për Fuqizimin e OShC-ve

"Qytetarët të Parët" – Konferencë Rajonale

Konferencë Rajonale - DIVAC

"Media dixhitale në një epokë të re: Rruga drejt vetërregullimit, etika dhe pavarësia" - Konferencë Rajonale

THIRRJE DHE MUNDËSI

Thirrje

Njoftime

Organizatat e Shoqërisë Civile i rekomandojnë Kuvendit të dërgojë për Opinion Ligjor në Komisionin e Venecias projektligjin "Për Regjistrimin e OJF-ve" dhe të shmangë miratimin e tij në kushtet e urgjencës

Në vijim të angazhimit për lehtësimin e procesit të konsultimit me sektorin për Projekt Ligjin "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse" dhe advokimit me institucionet përgjegjëse, më 26 shkurt 2021, 119 organizata të shoqërisë civile i`u drejtuan përfaqësuesve të Kuvendit të Shqipërisë me një deklaratë publike përmes së cilës i rekomandojnë Kuvendit të dërgojë për Opinion Ligjor në Komisionin e Venecias projektligjin "Për Regjistrimin e OJF-ve" dhe të shmangë miratimin e tij në kushtet e urgjencës! Gjeni KËTU deklaratën e plotë

Iniciativa për një projektligj të ri është shumë pozitive dhe e mirëpritur nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat prej vitesh e kanë kërkuar një të tillë, por me keqardhje vërejmë që fryma e institucioneve shtetërore përgjegjëse për hartimin, propozimin dhe shqyrtimin e këtij projektligji ka qenë përjashtuese për një sektor siç është shoqëria civile në vend, i cili preket drejtpërsëdrejti prej tij.

Sjellim në vëmendje se në hartimin e projektligjit nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësuesit e organizatave u ftuan të japin kontributin e tyre për këtë projektligj në procesin fundor. Pavarësisht afateve të ngushta të konsultimit, përfaqësuesit e OJF-ve ofruan kontributin e tyre në këtë proces, por Ministria e Drejtësisë reflektoi një numër tepër të ulët sugjerimesh si dhe nuk dha shpjegime për arsyet apo argumentat e refuzimit të rekomandimeve të tjera.

Vazhdon në faqen 2

BOTIMET MË TË FUNDIT



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA). Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.





Seancë dëgjimore në Parlament

Pasi projektligji u përcoll në Parlament, në tetor Kuvendit iu dërgua një Kërkesë për realizimin e një seance dëgjimore, seancë e cila u organizua disa muaj më pas, më 24 shkurt 2021, e për më tepër një ditë pas miratimit të projektligjit në parim nga Komisioni i Ligjeve.

Në seancën dëgjimore në Komisionin e Ligjeve diskutimet nga përfaqësuesit e OSHC-ve nxorën në pah një sërë problematikash parimore që projektligji ka. Megjithë shprehjen e gatishmërisë për të dëgjuar OJF-të dhe mirëpritur komentet e tyre, deklaratat e artikuluara gjatë seancës nga disa anëtarë të Komisionit të Ligjeve kishin nota paragjykuese ndaj sektorit.

Si Kuvendi por edhe Ministria e Drejtësisë më herët gjatë komunikimeve, prezantuan se ky projektligj adreson rekomandimet e MoneyVal të Këshillit të Evropës ndërkohë që çështjet e ngritura nga sektori i shoqërisë civile nuk prekin rekomandimet e MoneyVal.

Në vijim të seancës dëgjimore, Komisioni i Ligjeve ftoi OJF-të në një takim pune më 26 Shkurt 2021, për të vijuar më tej me diskutimet mbi problematikat e ngritura. Deklarata u nda gjerësisht me sektorin e shoqërisë civile, komunitetin donator, institucionet përgjegjëse dhe median e cila pasqyroi zhvillimet mbi këtë çështje.

Takim pune me Komisionin e Ligjeve

Nën koordinimin e Qendrës Burimore, një përfaqësi e grupimit të OJF-ve, parashtroi edhe njëherë para Komisionit të gjitha çështjet problematike duke theksuar edhe njëherë qëndrimin e OJF-ve që për sa kohë projektligji ka një sërë problematikash parimore, nuk mund të kalohet në diskutim nen për nen lidhur me to. Grupi përfaqësues gjithashtu, në emër të OJF-ve i dorëzoi Komisionit edhe kërkesën përmendur si më lart për t'ju drejtuar për një opinion ligjor Komisionit të Venecias si dhe dhe për të shmangur miratimin e tij në kushtet e urgjencës.

Pas takimit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, dërgoi për dijeni tabelën me komente dhe propozimet e relatores në projektligj. Për më shumë informacion, referojuni dokumentit.

PROJEKTLIGJ "PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE"	KOMENTE DHE PROPOZIME NGA RELATORJA
KREU I **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME** **Neni 1** **Objekti i ligjit** Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre për organizata jofitimprurëse të cilat kanë detyrimin për t'u regjistruar, sipas legjislacionit në fuqi që përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse.	
	Duke reflektuar sugjerimin e Grupit OSHC, propozoj shtimin e një neni të ri me përmbajtje si më poshtë: **"Neni 2** **Qëllimi i ligjit** Ky ligj ka për qëllim të lehtësojë procedurat e rregjistrimit të organizatave jofitimprurëse duke krijuar një mjedis transparent dhe mundësues për zhvillimin e veprimtarisë së tyre."
Neni 2 **Përkufizime** Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë: 1. "Dokumentet shoqëruese", dokumente, të cilat provojnë të dhënat që regjistrohen. 2. "Kërkesë për regjistrim", kërkesa që regjistrohet në gjykatën e	**Propozoj ndryshimet e mëposhtme:** 1. Pika 9 ndryshon si më poshtë: "9. "Regjistrim" është regjistrimi fillestar dhe çdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe **transformimin,**

Konstatojmë që një pjesë e komenteve dhe sugjerimeve janë reflektuar ndërkohë që të tjera çështje shqetësuese janë shtuar rishtazi. Masa e gjobës, parashikuar në Neni 48 të projektligjit "Kundravajtjet Administrative", është një masë intimiduese, disproporcionale dhe me efekt tepër negativ në veprimtarinë e sektorit. Ajo konsiderohet në shkelje të rëndë të parimit të proporcionalitetit të gjobës përkundrejt rëndësisë, pasojave të shkaktuara dhe rrethanave të kryerjes të kundravajtjes administrative (neni 18, Ligji 10279). Ajo bie ndesh po me Ligjin 10279, Për Kundravajtjet Administrative, ku në nenin 10, pika 1 përcaktohet se masa e dënimit me gjobë mund të jetë fikse ose me kufij minimal dhe maksimal.

Në kushtet e afateve të ngushta, Partnerët Shqipëri i përcolli menjëherë komentet mbi këtë draft të rishikuar Komisionit të Ligjeve.

Avokati i Popullit mbështet vazhdimin e konsultimeve për miratimin e projektligjit "Për regjistrimin e Ojf-ve"

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje debatin që po zhvillohet në lidhje me përpilimin dhe miratimin e një projektligji "Për regjistrimin e OJF"-ve në Republikën e Shqipërisë dhe është shprehur në mbështetje të organizatave të shoqërisë civile.

Avokati i Popullit i rekomandon Kuvendit të Shqipërisë që të mos ngutet në miratimin e një projektligji të pakonsultuar e të padakordësuar me aktorët e shoqërisë civile dhe u bën thirrje të gjithë grupeve të interesit që të japin kontributin e tyre konstruktiv me efikasitet, seriozitet dhe interesin e qytetarëve në mendje. Për më shumë

Ligji "Për regjistrin qendror të llogarive bankare "

Prej Janarit 2021 ka hyrë në fuqi Ligji "Për regjistrin qendror të llogarive bankare". Fusha e zbatimit të ligjit janë institucionet financiare, por me efekt të drejtpërdrejtë ndaj personave juridikë, përfshi edhe OJF-të.

Në tetor 2020, pasi morëm dijeni për projektligjin dhe u njohëm me të, në bashkëpunim me ekspertë dhe një grupim organizatash, analizuam projektligjin dhe ndikimin e tij në sektorin jofitimprurës dhe hartuam një Opinion ligjor që iu përcoll Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me kërkesën për të parë problematikat e ngritura dhe adresuar ato. Opinioni po ashtu u nda gjerësisht me organizata të shoqërisë civile, donatorë dhe institucione të tjera.

Pas miratimit të Ligjit, konstatuam që një pjesë e vogël e rekomandimeve janë reflektuar në ligj, respektivisht:

(1) Neni 8 pika 2 e Ligjit nuk parashikon shprehimisht që llogaritë e OJF-ve dhe të dhënat përkatëse të tyre do të jenë pjesë e Regjistrit. Megjithatë, termi 'person juridik' përfshin edhe OJF-të.
(2) Neni 8 pika 4 ka një dispozitë të shprehur e cila mundëson që Regjistri të mos mbajë të dhëna mbi shumat e llogarive bankare.
(3) Termi 'shumëqëllimor' në nenin që përcakton Regjistrin si një bazë të dhënash është hequr.
(4) Neni 10 nuk parashikon shprehimisht të drejtën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) për të kryer inspektime në vend apo në distancë.

Këto janë çështjet e pranuara dhe ndryshuara. Ndërkohë, sugjerimet e tjera në lidhje me organin që administron Regjistrin, të drejtat e institucioneve të interesuara për të marrë info, etj, nuk respektojnë garancitë kushtetuese të lidhura me to. Mbajtja dhe administrimi i Regjistrit nga një organ ekzekutiv si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe e drejta e DPT për të dhënë informacione institucioneve të interesuara pa konfirmimin e gjykatës janë pikat më të cënueshme të ligjit. Veçanërisht për këto pika, ligji mund të jetë subjekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese, e vënë në lëvizje nga subjektet që legjitimohen për t'ju drejtuar kësaj gjykate. Ligji i miratuar ka dhe shumë pika të tjera që janë në kundërshtim me ligjet e tjera dhe parimet bazë të krijimit të strukturave të institucioneve shtetërore (të identifikuara dhe në analizën ligjore të OSHC-ve në tetor 2020). Për më shumë Opinionin e plotë e gjeni këtu

Event Rrjetëzimi - Qendrueshmëria e organizatave rinore në periudhën e pandemisë dhe pas pandemisë



Nisur nga çështjet e ngritura nga OJF-të në Konferencën Kombëtare të Shoqërisë Civile në dhjetor 2020 si dhe nga interesi i organizatave pjesëmarrëse në workshopet tematike të konferencës, më 10 Mars 2021, Qendra Kombëtare Burimore dhe Partnerët Shqipëri organizuan online eventin e rrjetëzimit *"Qendrueshmëria e organizatave rinore në periudhën e pandemisë dhe pas pandemisë".*

Mbi 80 përfaqësues të OJF-ve, donatorë, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe vendore në vend, institucioneve akademike dhe medias morën pjesë në event dhe diskutuan mbi sfidat, adresimin e tyre dhe strategji të sigurimit të mbështetjes për OShC-të rinore në vend.

Situata e Covid-19 është shoqëruar me ndryshime në programet dhe aktivitetin në terren të OSHC-ve si dhe ka ndikuar në qendrueshmërinë financiare të tyre, veçanërisht të organizatave lokale. Pjesëmarrësit në eventin e rrjetëzimit sollën një panoramë të situatës përgjatë vitit të fundit të organizatave rinore dhe aktivitetit të tyre, prezantuan disa modele suksesi si dhe ndanë informacion mbi programe dhe strategji të institucioneve dhe organizatave e rrjeteve rinore.

Të ftuar në event ishin edhe përfaqësues të qeverisë në nivel qendror e vendor, znj. Aspasiana Kongo, zëvendës ministre, Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, znj. Anisa Subashi, Drejtore e Shërbimit Social në Bashkinë e Tiranës dhe Z. Engjëll Gjugja, Bashkia Shkodër, ndanë me pjesëmarrësit disa nga strategjitë e ndërmarra nga institucionet shtetërore në vend në mbështetje të të rinjve, organizatave rinore, të ndikuar nga situata e pandemisë Covid – 19.

Aktiviteti krijoi mundësi rrjetëzimi për OShC-të dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse, duke u ofruar mundësinë për të gjeneruar kontakte, prezantuar punën e tyre si dhe diskutuar konkretisht për nxitjen e dialogut dhe bashkëpunimit të të gjithë aktorëve dhe grupeve të interesit në krijimin e një mjedisi mundësues mbi këtë çështje .







Advokim dhe Dialog për Politikëbërje

Forcimi i rrjeteve dhe koalicioneve të OSHC-ve në Shqipëri për më shumë nisma dhe impakt më të madh





Qendra ka vijuar edhe ketë tre mujor ofrimin e mbështetjes për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të rrjeteve, koalicioneve si dhe grupimeve formale dhe informale të OShC-ve, nëpërmjet programit të asistencës teknike. Si pjesë e programit deri tani rrjetet janë asistuar në:

Rrjeti Kombëtar i Klimës - konsolidimin e brendshëm të rrjetit nëpërmjet hartimit të një Plani Strategjik dhe në draftimin e një Plan Advokimi mbi nismën për draftimin e ligjit mbi klimën në Shqipëri.

Rrjeti i Profesionistëve të Rinj - hartimin e Planit Strategjik për zhvillimin e rrjetit në tri vitet në vijim.

Forumi Civil Selenicë - hartimin e një Plani për Ngritjen e Fondeve, në mbështetje të nismave të tyre advokuese si dhe hartimin e një rregulloreje të brendshme për rregullimin e politikave të personelit.

Grupimi për zhvillimin e vullnetarizmit ka vijuar me takime dhe asisitencë për kuadrin ligjor të vullnetarizmit.

Krahas sesioneve të mentorimit dhe asistencës dizenjuar specifikisht bazuar në nevojat dhe prioritetet e rrjeteve, si pjesë e programeve të trajnimit, Qendra ka zhvilluar edhe disa trajnime për organizatat anëtare të rrjeteve në shkrim projekt propozimi si dhe ngritjen e fondeve. Për më shumë detaje mbi rezultatet dhe përfituesit e programit të asistencës lexoni këtu.

Në vijim, Qendra vazhdon bashkëpunimin me rrjetet dhe mbështetjen e tyre për të lehtësuar procese komunikimi me institucionet në vend, organizata të tjera e ekspertë, për të adresuar çështjet në fokus të veprimtarisë së rrjeteve.

Takim konsultues me OSHC-të mbi "Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit"

Në vijim të angazhimit për lehtësimin e proceseve të konsultimit me sektorin, pas shpalljes për konsultim publik të "Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit" nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizuan një takim konsultues OSHC-të. Takimi u zhvillua në fillim të muajit shkurt, online, me pjesëmarrjen e rreth 30 përfaqësuesve të OJF-ve të cilët diskutuan mbi manualin dhe adresuan problematikat apo mangësitë në dokument.

Si pjesë e takimit, OSHC-të ndanë opinionet dhe përvojat e tyre të viteve të fundit mbi pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse në Kuvend. Për më shumë mbi disa çështje të identifikuara dhe rekomandime të OSHC-ve mbi adresimin e tyre, gjeni KËTU një përmbledhje të diskutimeve.

Mbi Vullnetarizmin dhe zhvillimin e tij në Shqipëri



Qendra Kombëtare Burimore në bashkëpunim me Përtej Barrierave ka vijuar punën gjatë këtyre muajve për identifikimin e problematikave dhe sfidave që organizatat dhe grupet informale ndeshin gjatë zbatimit të kuadrit ligjor për vullnetarizmin. Në vijim të takimeve me OSHC dhe institucionet përgjegjëse në vend për zbatimin e kuadrit ligjor, më 21 janar u organizua një tryezë diskutimi online, me rreth 40 përfaqësues të organizatave dhe ekspertë ligjorë.

Avokate Ardjana Shehi, prezantoi për të gjithë pjesëmarrësit një analizë të kuadrit ligjor, kuptimit dhe detyrimeve që lindin për subjektet përkatëse sipas dispozitave të Ligjit nr.45/2016 "Për vullnetarizmin".

Për më shumë mbi problematikën e kuadrit ligjor dhe rekomandimet për adresimin më tej, gjeni këtu opinionin e plotë.

Qendra Burimore, Përtej Barrierave dhe Grupimi i organizatave që i janë bashkuar iniciativës për të kontribuar në zhvillimin e vullnetarizmit në Shqipëri (lexo këtu deklaratën publike të grupimit), do vijojnë takimet me institucionet për diskutimin e disa propozimeve konkrete që adresojnë problemet që ka ligji.

Advokim dhe Dialog për Politikëbërje

Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Vlorë

*Gjatë takime individuale me drejtues te OJF lokale mbi Kodin e Standardeve dhe asistencën e mundshme për secilin prej tyre - **Zyra Rajonale Vlorë***

*Tryeze diskutimi me përfaqësues të OShC-ve të Vlorës për të diskutuar mbi çështjet prioritare të qytetit si mbrojtja e Pyllit të Sodës dhe zonën e Akademisë së Marinës - **Zyra Rajonale Vlorë***

*Qendra Burimore për Shoqërine Civile Vlorë ka ofruar një seri shërbimesh help desk për OJF-të lokale, duke i mbështetur për shkrim projekt propozimesh si dhe pjesëmarrje në takime/trainime online të fushës së tyre të interesit - **Zyra Rajonale Vlorë***

Shkodër

*Gjatë takimit e organizuar nga bashkia Shkodër "Modelimi i qyteteve të drejta: Integrimi i Axhendës 2030 brenda politikave vendore, në kohën e flukseve të mëdha të migrimit dhe refugjatëve" - **Zyra Rajonale Shkodër***

*Gjatë Mbledhjes të Keshillit të Aleances së Zgjeruar të Grave Keshilltare –Këshilli Bashkiak Shkodër - **Zyra Rajonale Shkodër***

*Gjatë emisionit në studio mbi Shërbimin e Këshillimit të Karrierës që do të filloj të zbatohet në bashkinë e Shkodrës - **Zyra Rajonale Shkodër***

Fuqizim kapacitetesh

Akademia e OJF-ve

Prej muajit shkurt, ka rifilluar programi i Akademisë së OJF-ve për vitin 2021. Akademia është një program vjetor që u jep mundësinë drejtuesve të OSHC-ve dhe manaxherëve të nivelit të lartë të rrisin aftësitë dhe të zhvillojnë kompetenca. Pas një thirrje të hapur për shprehje interesi, 23 përfaqësues të OSHC-ve u zgjodhën për të marrë pjesë në Akademinë e këtij viti.

Programi i Akademisë, konsiston në ofrimin e **11 leksioneve** nga lektorë vendas dhe ndërkombëtarë si dhe diskutimeve me ekspertë të ftuar, **sesione mentorimi** për gjatë gjithë vitit për akademistët dhe organizatat e tyre, pjesëmarrje në **vizita studimore** në biznese dhe institucione, si dhe pjesëmarrje në evente të ndryshme të Qendrës Burimore e diskutime dhe aktivitete rrjetëzimi me akademistë të viteve të shkuara.

Gjatë muajve shkurt dhe mars janë zhvilluar dy leksionet e para respektivisht mbi "Kuadri Ligjor për OJF-të në Shqipëri" dhe "Procesi i integrimit të Shqipërisë në BE dhe roli i OSHC-ve".

Akademia e OJF-ve është një nga aktivitetet kryesore të Qendrës Kombëtare Burimore për ngritjen e kapaciteteve të sektorit. Për më shumë informacion, gjeni këtu programin si dhe një video të shkurtër me përfituesit e Akademia 2020.

Programe Trajnimi për OSHC-të

Gjatë kësaj periudhe Qendra Kombëtare Burimore ka vijuar me zhvillimin online të programeve të trajnimit të dedikuara për sektorin jofitimprurës bazuar në nevojat ose kërkesat e tyre.

Rreth 40 përfaqësues të OSHC-ve nga Tirana, Durrësi dhe Elbasani morën pjesë në trajnime dy ditore rajonale dhe rritën më tej njohuritë e tyre në temat e: "Shkrimi i Projekt Propozimit" dhe "Ngritja e Fondeve dhe Gjenerimi i të Ardhurave".



Sesione Informimi dhe Asistence mbi procedurën e regjistrimit të OJF-ve sipas ligjit "Për regjistrimin e pronarëve përfitues"

Prej muajit janar 2021 ka hyrë në fuqi ligji "Për regjistrin e pronarëve përfitues". Sipas ligjit, çdo subjekt raportues ekzistues, pra edhe organizatat jofitimprurëse, duhet të regjistrojë pronarin/ët përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues (RPP).

Qendra Kombëtare Burimore publikoi dhe ndau gjerësisht njoftimin në sektor, së bashku me disa udhëzime për procedurën e regjistrimit. Bazuar në kërkesat e shumta për informacion në adresë të Qendrës, nga organizata nga mbarë vendi, Qendra përgatiti dhe ndau informacion specifik mbi një seri çështjesh për të cilat kishte paqartësi.

Në vijim, në përgjigje të interesit të madh nga organizatat e shoqërisë civile, Qendra Burimore dhe Partnerët Shqipëri organizuan një sesioni informues mbi procedurën e regjistrimit të pronarëve përfitues. Identifikimi i pronarit, procedura e aplikimit për regjistrimin, dokumentet e nevojshme, nënshkrimi elektronik dhe afatet ishin çështjet kryesore te trajtuara gjate sesionit informuese. Për më shumë, ndiqni sesionin këtu!

Rreth 140 përfaqësues të OShC-ve kanë marrë informacione dhe përgjigje për pyetjet në kohë reale, si dhe janë asistuar individualisht deri tani për çështje specifike në lidhje me procedurën e regjistrimit. Për më shumë







Forumi Kombëtar 'Qeverisje për Ndryshim: Propozime të Shoqërisë Civile'

Në 23 shkurt 2021, u organizua Forumi Kombëtar 'Qeverisje për Ndryshim: Propozime të Shoqërisë Civile'. Forumi u zhvillua nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit dhe Westminster Foundation for Democracy në bashkëpunim me një spektër të gjerë organizatash kontribuese dhe partner mediatik A2 CNN – Exclusive News Channel Affiliate. I organizuar në sesione tematike, Forumi u konceptua si një platformë para-elektorale, ku aktorë të shoqërisë civile nga sektorë të ndryshëm dhe me mandate të qarta përfaqësuese parashtruan problematika dhe propozime për ndryshim. Në sesionin e dytë tematik, Znj. Juliana Hoxha, Drejtore e Partnerët Shqipëri parashtroi analizën dhe rekomandimet për Shoqërinë Civile, të cilat i gjeni në dokumentin këtu

Bazuar në propozimet e paraqitura, u hartua një dokument i cili përmban propozimet për ndryshime me fokus në zhvillim ekonomik dhe rajonal; qeverisje dhe decentralizim; edukim, kërkim shkencor dhe media; mjedis, energji dhe ndryshimet klimatike; shëndet dhe siguri ushqimore; të drejtat e njeriut, rini, art dhe kulturë. Lexoni dokumentin këtu

Kuadri ligjor dhe rregullator mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit për sektorin jo-fitimprurës në Shqipëri

Përgjatë marsit 2021, Partnerët Shqipëri kanë zhvilluar një sërë tryezash diskutimi mbi "Kuadri ligjor dhe rregullator mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit për sektorin jo-fitimprurës në Shqipëri" në nivel lokal.

Qëllimi i tryezës ishte informimi, prezantimi dhe diskutimi i gjetjeve kryesore të raportit që po përgatitet nga Partnerët Shqipëri mbi kuadrin ligjor dhe rregullator që rregullon veprimtarinë e OJF-ve në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe pajtueshmërinë e masave të ndërmarra nga shteti shqiptar me Rekomandimin 8 dhe Notën Shpjeguese të Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar (FATF) për organizatat jo-fitimprurëse. Për më shumë mbi këto aktivitete lexoni këtu

Në vijimësi të kësaj pune, Partnerët Shqipëri në 18 mars organizuan një workshop rajonal ku organizata të shoqërisë civile nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë ndanë eksperiencat rreth angazhimit të tyre në analizën e riskut për sektorin e OJF-ve dhe bashkëpunimin me Agjensitë e Inteligjencës Financiare në vendet respektive.

Lufta ndaj financimit të terrorizmit dhe parandalimit të pastrimit të parave, çfarë vendi zënë OJF në këtë çështje dhe si trajtohen ato në nivel global nga institucionet përgjegjëse, për këto dhe të tjera informacione ndiqni videon, pjesë e fushatës informuese dhe ndërgjegjësuese përgatitur nga Partnerët Shqipëri.

Negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian dhe eksperienca rajonale – Kapitulli 23 në fokus





Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) dhe Ministria e Drejtësisë në partneritet me Shoqatën Sllovake për Politikën e Jashtme (SFPA), zhvilluan më 5 shkurt, 2021, Konferencën Virtuale mbi procesin e negociatave të Shqipërisë me fokus të veçantë në Kapitullin 23.

Aktiviteti solli së bashku pjesëmarrës nga institucionet shqiptare - pjesë të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Europian për Kapitullin 23, i cili është përgjegjës për harmonizimin dhe zbatimin e acquis-së, koordinimin e përgatitjes së procesit Screening dhe përgatitjen e pozicionit negociator për këtë Kapitull. Diskutimi u pasurua edhe nga partnerë ndërkombëtarë, institucione të tjera publike, akademikë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që janë proaktive në fushën e proceseve të integrimit europian në vend. Për më shumë

Workshop Kombëtar "Nisma qytetare në veprimtarinë vendimmarrëse të Parlamentit"



Në kuadër të një nisme që Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit po zbatojnë dhe që ka si objektiv krijimin e një mjedisi lehtësues për përfshirjen aktive të qytetarëve në proceset legjislative dhe vendimmarrëse në Parlament si një mjet për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e këtij institucioni dhe përfaqësuesve të zgjedhur, më 10 mars u organizua online një workshop Kombëtar, me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, institucioneve donatore në vend, grupeve të interesit e aktivistëve.

I konceptuar në 9 workshope tematike, për ti ardhur në ndihmë shoqërisë civile, grupeve të interesit dhe qytetarëv të angazhuar për të strukturuar më mire propozimet dhe për të artikuluar më mirë nismat e tyre në një procedurë parlamentare, moderatorë dhe ekspertë të fushave përkatëse lehtësuan diskutimet tematike dhe udhëzuan pjesëmarrësit për punën më tej. Ariola Agolli, Drejtore e Programeve pranë Partnerëve Shqipëri dhe Manaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore, si pjesë e grupit të moderatorëve lehtësoi diskutimet mbi mjedisin mundësues për shoqërinë civile dhe disa nisma në këtë drejtim. Për më shumë ndiqni live aktivitetin këtu

VullnetarizmiPikëAL

Organizata Përtej Barrierave në partneritet me Projektet Vullnetare Ndërkombëtare dhe Qendrën "Progres dhe Zhvillim", lançuan në 29 janar iniciativën më të fundit VullnetarizmiPikëAL. Si pjesë e aktivitetit, përfaqësues të shoqërisë civile, institucioneve publike si Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Agjencia Kombëtare e Rinisë, Bashki të qarqeve të ndryshme dhe të rinj të interesuar, u njohën konkretisht me iniciativën e cila synon të krijojë një mjedis mundësues shumë dimensional ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet dhe njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e qytetarisë aktive, solidaritetit dhe kohezionit social në Shqipëri.



Gjatë eventit, Drejtorja e Përtej Barrierave, Znj. Ana Dervishi iu drejtua me një ftesë të hapur bashkëpunuese të gjithë të pranishmëve me dëshirën e mirë që të gjithë bashkë përmes një fryme bashkëpunuese të mund të rregullojmë të gjithë problematikat lidhur me angazhimin vullnetar në vend. Njihuni me projektin

Konferencë Kombëtare "1 Vit Ligji i Rinisë"



Në 14 shkurt, u mbajt online Konferenca Kombëtare "1 Vit Ligji i Rinisë", një event 2 ditor i organizuar nga Qendra "Epoka e Re", me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile, rrjeteve e aktivistëve, përfaqësuesve të institucioneve donatorë si dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor e qendror.

Si pjesë e paneleve u diskutua mbi tematikat me rëndësi që adresojnë zbatimin e Ligjit për Rininë në Shqipëri dhe zhvillimet rreth tij. Pjesëmarrës e panelsitë në vijim u ndanë e diskutuan në 4 grupe pune të fokusuara në: Strukturat rinore në nivel lokal; Buxheti i rinise; Strukturat rinore qendrore dhe Puna rinore. Rezultatet dhe rekomandimet e këtyre grupeve u prezantuan gjatë ditës së dytë të konferencës. Për më shumë mbi konferencën dhe dokumentin me konkluzionet dhe rekomandimet, lexoni këtu.

Raport për pjesëmarrjen e publikut dhe shoqërisë civile në procesin vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2020

Kuvendi i Shqipërisë ka hartuar dhe publikuar për të gjashtin vit radhazi raportin "Për Pjesëmarrjen e Publikut dhe Shoqërisë Civile në Procesin Vendimmarrës të Kuvendit për vitin 2020". Raporti synon të informojë publikun mbi veprimtarinë e Kuvendit, mbi përfshirjen dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile, por edhe organizata ndërkombëtare si dhe institucione publike, pjesëmarrja e të cilave ka qenë aktive në veprimtarinë e Kuvendit.

Lexoni raportin e plote këtu



Kuvendi Miraton Ndryshime të Rëndësishme të Reformës në Drejtësi në Mungesë të një Procesi Konsultimi dhe Transparence - Deklaratë për media

71 Organizata të Shoqërisë Civile i bashkohen reagimit publik për miratimin pa një konsultim gjithëpërfshirës, transparent dhe në cënim të Rregullores së Kuvendit, të paketës për ndryshime në 10 ligje të Reformës në Drejtësi. Shoqëria civile shpreh shqetësimin për procesin e miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të dhjetë projektligjeve të lidhura me paketën e reformës në drejtësi.

Kuvendi ka miratuar në seancën e fundit plenare më datë 23 mars, dhjetë projektligje në shkelje të procedurës sipas neneve 26, 27 dhe 28 të Rregullores së Kuvendit, për zhvillimin e seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të cilat kryhen sipas një programi pune të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve. Deklaratën e plotë e gjeni këtu


DEKLARATË PËR MEDIA – KUVENDI MIRATON NDRYSHIME TË RËNDËSISHME TË REFORMËS NË DREJTËSI NË MUNGESË TË NJË PROCESI KONSULTIMI DHE TRANSPARENCE

Shoqëria civile shpreh shqetësimin për procesin e miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë të dhjetë projektligjeve të lidhura me paketën e reformës në drejtësi. Kuvendi ka miratuar në seancën e fundit plenare dhjetë projektligje në shkelje të procedurës sipas neneve 26, 27 dhe 28 të Rregullores së Kuvendit, për zhvillimin e seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të cilat kryhen sipas një programi pune të miratuar nga Konferenca e Kryetarëve.

Dje, me propozim të Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Kuvendi, vendosi të fusë në rendin e ditës diskutimin dhe miratimin e dhjetë projektligjeve që njëllin 154 ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal, Kodet e Procedurës Penale dhe Civile, ligjet organike të Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë, ligjet për organizimin e sistemit gjyqësor dhe institucionet e reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Shoqëria civile shpreh shqetësimin se procesi i ndjekur për shqyrtimin dhe miratimin e këtyre projektligjeve krijon precedent negativ, pasi bie në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe Rregulloren e Kuvendit.

Neni 83, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ndalon zbatimin e procedurës së përshpejtuar në shqyrtimin e projektligjeve që kërkojnë shumicë të cilësuar të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Gjithashtu, e gjithë procedura e ndjekur, nga Komisioni i Ligjeve deri në miratimin e këtyre projektligjeve në seancë plenare, është kryer në mungesë të transparencës me publikun dhe konsultimit me të gjitha

Raporti - Country Gender Equality Brief Albania 2020 – UN Women

Në shkurt, UN Women publikoi raportin "Country Gender Equality Brief Albania 2020". Raporti synon të ofrojë një pamje të barazisë gjinore dhe situatës së grave në Shqipëri, veçanërisht në lidhje me treguesit e barazisë gjinore ndër Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Duke ndjekur metodologjinë dhe modelin e UN Women, dhe në konsultim me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (UNCT) në Shqipëri, CGEB bazohet në një rishikim të literaturës dhe përdor të dhëna zyrtare të prodhuara para (dhe pjesërisht gjatë) krizës së shkaktuar nga COVID-19. Gjeni këtu raportin

TACSO 3 - Takime konsultuese për Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2021-2027

EU TACSO 3 organizoi një seri konsultimesh online me vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë, lidhur me Udhëzuesin e BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit, 2021-2027.

Mbi 300 përfaqësues të shoqërisë civile, autoriteteve publike, donatorëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar morën pjesë në prezantimin e dokumentit të Udhëzuesit dhe dhanë rekomandime gjatë diskutimit.

Takimi konsultues në Shqipëri, u zhvillua në 2 mars 2021. Përgjatë diskutimeve, pjesëmarrësit ndanë idetë e tyre mbi disa çështje të rëndësishme të Udhëzuesit në lidhje me organizatat me bazë komunitare dhe nismat joformale, marrëdhëniet me institucionet shtetërore, kapacitetet e OSHC-ve dhe mjedisi mundësues. Vëmendje të veçantë si pjesë e diskutimeve mori projektligji për Regjistrimin e OJF-ve, si një ndër ligjet bazë të funksionimit të OJF-ve. Për më shumë

Hartëzimi dhe Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të Rrjeteve të OSHC-ve në Rajon dhe Projekteve Rajonale të financuara nga CSF

Më 11 Shkurt 2021, TACSO 3 organizoi një event online për prezantimin e gjetjeve kryesore të raportit të vlerësimit të kapaciteteve dhe nevojave të rrjeteve rajonale dhe projekteve rajonale të financuara nga CSF.

Më shumë se 80 përfaqësues të OShC-ve dhe institucioneve të BE morën pjesë në takim. Pjesëmarrës e panelistë, përfaqësues të rrjeteve të ndryshme në Ballkanin Perëndimor u ftuan për të ndarë ekperiencat, arritjet dhe sfidat e tyre.

Diskutimi vibrant u bazua mbi studimin e kryer mbi rrjetet rajonale, studim ky me pjesëmarrjen e më shumë se 200 individëve dhe organizatave nga i gjithë rajonin. Studimi fokusohet në dy aspekte kryesore të rrjeteve: 1) rrjetëzimi i rrjeteve të OSHC-ve; dhe 2) vlerësimi i kapaciteteve aktuale të rrjeteve dhe nevojave të tyre për fuqizimin e mëtejshëm. Më shumë rreth eventit mund te lexoni këtu

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore mund të gjenden këtu

Konferencë Rajonale mbi Praktikat më të Mira për Fuqizimin e OShC-ve

Më datë 29 janar 2021, Qendra Burimore për OSHC-të në Kosovë, Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ) Kosovë në bashkëpunim me Institutin për Politika Zhvillimore (INDEP), organizuan Konferencën Rajonale "Praktikat më të mira për fuqizimin e OSHCve".

Konferenca synonte pasqyrimin e gjendjes aktuale dhe sfidave të sektorit jofitimprurës në Kosovë dhe më gjerë në rajon, në kushtet e situatës së krijuar nga Covid-19. Pjesë e panelistëve në këtë event ishte dhe koordinatorja e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Znj. Xhoana Zeqo.

Sigurimi i vazhdueshmërisë së shërbimeve dhe aktivitetit të OJF-ve, nevoja për zhvillimin e kapaciteteve dhe rritjen e aftësive për përshtatjen e veprimtarisë tashmë online si dhe nevoja për më shumë koordinim në kuadër të ndarjes së praktikave të mira të përshtatshmërisë dhe gjenerimit të burimeve alternative të financimit të sektorit ishin ndër çështjet e ngritura prej saj në diskutim.

"Qytetarët të Parët" – Konferencë Rajonale

Në Shkurt 2021, u mbajt Konferenca e Dytë Rajonale "Qytetarët të Parët" në kuadër të WeBER2.0, një iniciativë rajonale kushtuar fuqizimit të shoqërisë civile dhe qytetarëve për të qenë më të gatshëm për të monitoruar dhe kontrolluar procesin e reformës së administratës publike. Konferenca u organizua nga Qendra Evropiane e Politikave (CEP), në bashkëpunim me pesë organizata të tjera rajonale nga Ballkani Perëndimor pjesë e Rrjetit Mendo për Evropën.

Gjatë dy ditëve të konferencës, pjesëmarrës nga rajoni dhe Evropa patën mundësinë për të diskutuar progresin dhe sfidat me të cilat përballet shoqëria civile në monitorimin e procesit të reformës së administratës publike. Për më shumë

Konferencë Rajonale - DIVAC



Rrjeti rajonal "Youth Hub për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë" (*i përbërë nga 5 organizata partnere - Community Volunteers Foundation TOG, Turqi, Fondacioni Ana dhe Vlade Divac, Serbi, Mladiinfo International, Maqedoni e Veriut, OJF "Prima", Mali i Zi dhe Partnerët Shqipëri),* organizuan gjatë muajit mars konferencën rajonale "Qendrueshmëria e organizatave rinore në periudhën e pandemisë dhe pas pandemisë".

Gjatë konferencës u adresuan çështje të qendrueshmërisë së organizatave rinore në periudhën post-pandemike dhe sfidat kryesore me të cilat përballet sektori i shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor. Ndarja e praktikave të mira dhe shkëmbimi i eksperiencave midis rreth 200 përfaqësuesve nga 5 vendet e Ballkanit Perëndimor ishin një vlerë e shtuar e konferencës.

Konferenca u përshëndet nga drejtues të lartë të institucioneve Evropiane në mbështetje të rinisë si: *Znj. Liselotte Isaksson, DG NEAR, Znj. Sylvia Ivanova, Fondacioni Evropian për Rininë; Z. Jan Zlatan Kulenović, RYCO; Dr. Gjergj Murra, Western Balkan Fund; Znj. Tanja Hafner Ademi, EU TACSO 3,* të cilët prezantuan gjetje mbi situatën dhe prespektiva zhvillimi në mbështetje të të rinjve dhe OSHC-ve rinore në Ballkan dhe Evropë. Për më shumë

"Media dixhitale në një epokë të re: Rruga drejt vetërregullimit, etika dhe pavarësia" - Konferencë Rajonale

Në 18-19 Mars, Komiteti Shqiptar i Helsinkit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ambasadës së Mbretësisë së Vendeve të Ulta organizoi një konferencë rajonale të medias Ballkanin Perëndimor. Përgjatë 2 ditëve, përmes një formati hibrid, me prezencë të kufizuar fizike dhe online, ekspertët nga Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kosova, Serbia, Mali i Zi dhe Hercegovina, por edhe nga Holanda, Italia dhe gjyqtarë të Gjykatës Evropiane të të Drejatve të Njeriut, ndanë pikëpamjet e tyre mbi tema të rëndësishme që lidhen me median, sikurse janë: Etika, vetërregullimi, liria e shprehjes, pavarësia e medias etj.

Për më shumë mbi Konferencën, prezantimet e ekspertëve dhe diskutimet, informohuni këtu





THIRRJE DHE MUNDËSI

KALENDAR TREMUJOR

Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!

Prill 2021

S	M	T	E	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

Maj 2021

S	M	T	E	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28						

Qershor 2021

S	M	T	E	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			

Akademia e OJF-ve

Trajnime dhe Seminare për OShC-të

Aktivitete rrjetëzimi

Forume Publike dhe Evente

NA KONTAKTONI :

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë

(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim")
Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr. Oso Kuka, Kati i 2të, Hyrja 1, Shkoder
(në mjediset e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim")

E-mail: shkodra@resourcecenter.al

Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë

(në mjediset e Qendrës "Aulona")
Tel: +355 3 3224531

E-mail: vlora@resourcecenter.al

NA NDIQNI : @resourcecentre.al @resourcecentrealbania @resourceCSO_al @ResourceCentreAlbania

@http://www.resourcecentre.al/